

Situata aktuale e licencimit

Aktualisht për kërkimin e naftës dhe gazit në Shqipëri, janë të lidhura disa Marrëveshje Hidrokarbure, në bazë të të cilave zhvillojnë aktivitetin e tyre një sërë kompanish, si më poshtë:

Për kërkimin e naftës dhe gazit në det:

- Marrëveshja me Ndarje Prodhimi për bllokun e Durrësit me kompaninë San Leon Energy, e cila ka hyrë në fuqi në Gusht të vitit 2004;
- Marrëveshja me Ndarje Prodhimi për bllokun Joni 5 me kompaninë Capricorn Albania, e cila ka hyrë në fuqi në Shtator të vitit 2007.

Për kërkimin e naftës dhe gazit në tokë:

- Marrëveshja me Ndarje Prodhimi për blloqet A + B me kompaninë Petromanas Albania GmbH, e cila ka hyrë në fuqi në Dhjetor të vitit 2007;
- Marrëveshja me Ndarje Prodhimi për bllokun D + E me kompaninë Petromanas Albania GmbH, e cila ka hyrë në fuqi në Dhjetor të vitit 2007;
- Marrëveshja me Ndarje Prodhimi për bllokun 2 + 3 me kompaninë Petromanas Albania GmbH, e cila ka hyrë në fuqi në Korrik të vitit 2009;
- Marrëveshja me Ndarje Prodhimi për bllokun F me kompaninë Bankers Petroleum Albania, e cila ka hyrë në fuqi në Nëntor të vitit 2010;

Ndërkohë për disa nga blloqet e lirë janë marrë aplikime të cilat janë duke u vlerësuar (shih hartën).

Në fushën e zhvillimit të vendburimeve dhe prodhimit të naftës dhe gazit;

- Licensë-Marrëveshja e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Patos-Marinzës mes Albpetrolit dhe kompanisë Bankers Petroleum Albania, e cila ka hyrë në fuqi në Korrik të vitit 2004;
- Licence-Marrëveshja e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Ballsh - Hekalit mes Albpetrolit dhe kompanisë Stream Oil & Gas, e cila ka hyrë në fuqi në Gusht të vitit 2007;
- Licence Marrëveshja e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Cakran – Mollajt mes Albpetrolit dhe kompanisë Stream Oil & Gas, e cila ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2007;
- Licence Marrëveshja e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Gorisht - Koculit mes Albpetrolit dhe kompanisë Stream Oil & Gas, e cila ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2007;
- Licencë-Marrëveshja e lëshuar nga Ministria dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Ballsh - Hekalit mes Albpetrolit dhe kompanisë Stream Oil & Gas, e cila ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2007;
- Licencë-Marrëveshja e akorduar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Marrëveshja Hidrokarbure, për vlerësimin dhe zhvillimin e zbulimit të bërë në bllokun e Delvinës dhe prodhimin e hidrokarbureve në të, mes Albpetrolit dhe kompanisë Stream Oil & Gas, e cila ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2007;

- Licencë-Marrëveshja e akorduar nga Ministria dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Kuçovës mes Albpetrolit dhe kompanisë Sherwood, e cila ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2007;
- Licencë-Marrëveshja e akorduar nga Ministria dhe Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin e Visokës mes Albpetrolit dhe kompanisë IEC Visoka, e cila ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2009;

Nga këto marrëveshje:

- Marrëveshja Hidrokarbure me Bankers Petroleum Albania për zhvillimin e vendburimit dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos - Marinëz është në fazën e zhvillimit;
- Marrëveshja Hidrokarbure me Sherwood për zhvillimin e vendburimit dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Kuçovës është në fazën e zhvillimit;
- Marrëveshjet Hidrokarbure me Stream Oil & Gas për zhvillimin e vendburimeve dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Ballësh-Hekal, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul dhe Delvinë, ndodhen në fazën e zhvillimit;
- Marrëveshja Hidrokarbure me Transoilgroup, për zhvillimin e vendburimit dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Visokës, është në fazën e vlerësimit.

ALBANIA

LICENSING SITUATION NOVEMBER 2011

